



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

RAPORTI I MONITORIMIT 8-MUJORI I 2019-ës

MIRATOI

Lorin YMERI

Drejtor Ekzekutiv

**SHTATOR 2019
ADISA**

Tabela e përmbajtjes

I.	Hyrje	3
II.	Qëllimet, objektivat dhe treguesit e performancës.....	3
	A. Treguesit e performancës ne nivel qëllimi.....	4
	B. Treguesit e performancës në nivel objektivi.....	4
III.	Buxheti i miratuar dhe faktik për 4 mujorin e parë të vitit 2019.....	12

I. Hyrje

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) është person juridik publik, i organizuar në formën e agjencisë autonome të krijuar me Ligjin nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”.

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit 99, datë 3.12. 2018 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe mbështetur në Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore” po Ju paraqesim raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2019.

Në realizimin e këtij raporti Ekipi i Menaxhimit të Programit ka bërë monitorimin e vazhdueshëm nëpërmjet procesit të vlerësimit dhe krahasimit të treguesve faktik të performancës me ata të planifikuar. Ky raport në vijim është miratuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Qëllimi i këtij monitorimi ishte ndjekja e vazhdueshme e arritjes së objektivave të synuar të përcaktuar tashmë në deklaratën e programit “Transformimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve në Shqipëri përmes qasjes me në qendër qytetarin duke realizuar ndarjen funksionale dhe integrimin e shërbimeve publike në sportel, zhvillimin e kanaleve të ofrimit të shërbimeve, marrjen e opinionëve të qytetarëve dhe monitorimin e lëvrimit të shërbimeve të standardizuara.”

Në përfundim të këtij raporti, informacioni i marrë shërbeu për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit për periudhën në vijim. Ekipi i Menaxhimit të Programit monitorimin e objektivave e ka bërë bazuar në treguesit e performancës, në sasi dhe vlerë për produktet, si një proces që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse.

Në vijim të këtij raporti do të gjeni një informacion të hollësishëm, të problematikave, mangësive të vërejtura, ecurinë e realizimit të qëllimit dhe objektivave të politikës, realizimin e produkteve krahasuar me planin në terma sasiore dhe cilësorë shoqëruar me argumentet përkatës, konkluzionet si dhe propozimet konkrete për periudhën në vijim në lidhje me ndryshimet për rishikimin apo jo të politikës së programit apo propozime të tjera për përmirësimin e situatës.

II. Qëllimet, objektivat dhe treguesit e performancës.

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) ka vijuar me kryerjen e shpenzimeve buxhetore brenda programit të vetëm buxhetor me emërtesën: **“Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike”** ku përfshihet buxheti i miratuar dhe akorduar për vitin buxhetor 2019, i ndarë sipas artikujve ekonomikë.

Nëpërmjet këtij programi synohet konsolidimi i rregullave për ofrimin e shërbimeve publike të integruara ndaj publikut në mënyrë të drejtë për drejtë, nëpërmjet sporteleve në Qendrat e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, përmes heqjes së pengesave administrative dhe ofrimit të shërbimeve në mënyrë të shpejtë, efikase, transparente dhe me cilësi të lartë.

Për matjen e performancës së programit nga Ekipi i Menaxhimit të Programit janë evidentuar dhe matur treguesit në nivel qëllimi dhe treguesit në nivel objektiv, si me poshtë vijon:

A. Treguesit e performancës në nivel qëllimi

1. Numri i shërbimeve të ri-inxhinieruara;
2. Numri i shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ndaj totalit të shërbimeve publike;
3. Rritja e kënaqësisë së qytetarëve në marrjen e shërbimeve në sportelet ADISA;

Realizimi i tyre paraqitet në tabelën më poshtë:

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	Plan	Fakt	% Realizimit
Numri i shërbimeve të ri-inxhinieruara	424	424	100%
Numri i shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ndaj totalit të shërbimeve publike	415/1300	418/1300	101%
Rritja e kënaqësisë së qytetarëve në marrjen e shërbimeve në sportelet ADISA	74%	100%	135%

B. Treguesit e performancës në nivel objektiv

1. Numri i Qendrave/Njësive të Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara;
2. Numri i Bashkive (jo qendër-qarku) në të cilën ADISA është prezent nëpërmjet sporteleve të saj;
3. Numri i njësive lëvizëse për ofrimin e shërbimeve publike;
4. Numri i kartelave informative të standardizuara për shërbimet publike ndaj totalit të shërbimeve publike;
5. Numri i formularëve të aplikimit, të standardizuar për shërbimet publike;
6. Matja e kohës së shërbimit në sportelet pritëse

Realizimi i tyre paraqitet në tabelën më poshtë:

Treguesit e Performancës në nivel Objektiv	Plan	Fakt	% realizimit
Numri i Qendrave/Njësive të Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara	9	7	78%
Numri i Bashkive (jo qendër-qarku) në të cilën ADISA është prezent nëpërmjet sporteleve të saj	6	5	83%

Numri i njësive lëvizëse për ofrimin e shërbimeve publike	1	1	100%
Numri i kartelave informative të standardizuara për shërbimet publike ndaj totalit të shërbimeve publike	970/1300	978/1300	101%
Numri i formularëve të aplikimit, të standardizuar për shërbimet publike	310	325	105%
Matja e kohës së shërbimit në sportelet pritëse.	4'	4'	100%

Më poshtë po Ju paraqesim një argumentim të shkurtër të vlerave të realizimit të vendosura nga ana jonë, si më poshtë:

- Treguesi A.1 - Numri i shërbimeve të ri-inxhinieruara.

Gjatë vitit 2016 filloi procesi i ri-inxhinierimit të 400 shërbimeve. Në përfundim të këtij procesi janë propozuar ndryshime për 65 projekt-akte për 10 institucione, përkatësisht: 2 projektligje, 29 projektvendime, 13 urdhra ministri, 13 udhëzime dhe 8 rregullore.

Hartat TO-BE, të shërbimeve të përmirësuara të 10 institucioneve në fokus, janë 382. Ndryshimi nga numri i shërbimeve në AS-IS i dedikohet eliminimit, bashkimit dhe ri-konceptimit të shërbimeve. Nga konsulenti janë përpiluar rekomandime për të gjitha sistemet TIK. Konsulenti ka propozuar eliminimin e 91 dokumenteve dhe integrimin e 182 dokumenteve.

Në vijim të këtij procesi gjatë periudhës raportuese ADISA ka ndërmarrë angazhimet e mëposhtme:

➤ **Thjeshtëzimi dhe optimizimi i procedurave dhe dokumentacionit për shërbimet publike**

Në kuadër të prioritetit të Qeverisë Shqiptare për përmirësimin e shërbimeve publike dhe në zbatim të Ri-inxhinierimit të shërbimeve publike, ku në fokus u përzgjedhën 15 institucione nga kabineti i Zv/ Kryeministrit, u kërkuar asistencë e ADISA në mënyrë që këto institucione të realizojnë ri-inxhinierimin e shërbimeve të ofruara nga këto të fundit. Në përmbushje të këtij objekti, ekipi i ri-inxhinierimit ADISA zhvilloi takime me grupet e punës të institucioneve si vijon: Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP), Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) dhe Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR).

Me institucionet e ATP, QSHA dhe SHKP u zhvilluan takime me grupet e punës, me qëllim analizimin e listës së shërbimeve të këtyre të fundit. Ekipi i ri-inxhinierimit ka ndarë me institucionet skemat e shërbimeve me përmirësimet e propozuara nga projekti i ri-inxhinierimit në lidhje me këto shërbime. Në këtë proces janë përfshirë 25 shërbime publike që ofron SHKP-ja, 7 shërbime publike të ofruara nga ATP si dhe 10 shërbime publike të QSHA-së.

Në total në procesin e ri-inxhinierimit në 4 mujorin e parë të 2019 janë përfshirë 42 shërbime publike.

- Verifikimi i proceseve të punës për ofrimin e shërbimeve publike

ADISA, në bashkëpunim me projektin e BE “Mbështetje për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike me në qendër qytetarin” ka ndërtuar platformën për inventarizimin e shërbimeve publike. Kjo Platformë është konceptuar si një ndërveprim mes institucionit dhe ADISA për shkëmbim të dhënash mbi shërbimet publike dhe mbledhjen e informacionit mbi afatet ligjore, tarifat, ku mund të aplikohet si dhe informacione të tjera për procedurat BO, të cilat do të përdoren në momentin kur institucionit do t’i nënshtrohen procesit të ri-inxhinierimit të shërbimeve publike. Informacioni i mbledhur nga Platforma IPSD do të shërbejë për të ndjekur në vijim procesin e ri-inxhinierimit të shërbimeve publike dhe standardizimit të shërbimeve publike, duke gjeneruar Kartelat Informative, si dhe Formularët e Aplikimit.

Sa më sipër, e në vijim të bashkëpunimit ndërinstitutional, ADISA është angazhuar në 3 faza, përkatësisht: (i) prezantimi i Platformës tek institucionet publike, (ii) Validimi i listës së shërbimeve dhe (iii) plotësimi i Platformës.

- Treguesi A.2 - Numri i shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ndaj totalit të shërbimeve publike.

Në vijim të punës për shtimin e numrit të shërbimeve në Zyrat Rajonale/Vendore ADISA, si dhe bazuar Ligj Nr. 13, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, ADISA ka analizuar bazën ligjore të shërbimeve publike të ofruara nga institucionet, përkatësisht: ALUIZNI-n, Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP), Posta Shqiptare me të cilat janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për shtimin e numrit të shërbimeve që do të ofrohen pranë Zyrave Rajonale/Vendore ADISA si më poshtë vijon:

- Në zbatim të ligji nr. 111/2018 “Për kadastrën” ALUIZNI dhe ZRPP-ja funksionojnë si një institucion i vetëm ASHK. Me qëllim të mbarëvajtjes së procesit të aplikimit të shërbimeve dhe në përmbushje të funksionit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) tashmë në sportelet e Zyrave Rajonale/Vendore ADISA ofrohen edhe 4 shërbimet e legalizimit.
- Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të nënshkruar mes dy institucioneve më datë 19.12.2018 për ofrimin e shërbimeve publike të SHKP-së pranë sporteleve ADISA, aktualisht 20 prej tyre kanë filluar të pilotohen në Zyrën Vendore Krujë, Kavajë dhe Zyrën Rajonale Gjirokastrë, Fier. Për sa i takon shërbimit “Përfitimi i të ardhurave nga papunësia (pagesa e papunësisë)” me kod AL113041, shërbim ky jo i përfshirë në listën e 20 shërbimeve të SHKP-së për shkak të natyrës së shërbimit tashmë është dakordësuar me SHKP-në dhe është dakordësuar me këtë të fundit për ofrimin e shërbimit të sipërcituar, pranë zyrave ku ADISA funksionon me kolokim pranë bashkive Maliq, Belsh dhe Patos si dhe në njësinë lëvizëse që do të operojë në Tiranë dhe Shkodër.
- Posta Shqiptare sh.a është shoqëri publike me kapital shtetëror e shtrirë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, e cila ofron një gamë të gjerë shërbimesh të ndara në dy kategori: a) shërbime postare dhe b) shërbime financiare. Grupi i parë i shërbimeve janë

Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark”, ish Hoteli i Oficerave, kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al

shërbime të Postës Shqiptare ndërsa për sa i takon grupit të dytë të shërbimeve janë pagesa të kryera për llogari të shërbime publike të institucioneve të tjera. Në bazë të nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar midis Postës Shqiptare dhe ADISA prej muajit Shkurt 2019 është bërë e mundur ofrimi i të gjitha shërbimeve që kryen Posta Shqiptare edhe pranë Zyrave Rajonale/Vendore ku ADISA shtrin aktivitetin e sa.

Gjithashtu në bashkëpunim me AKSHI-n është bërë e mundur ngitja e një sporteli për shërbimet elektronike ku qytetarët do të asistohen nga punonjësit e ADISA për të përfutur të shërbimet që ofrohen me vulë dixhitale. Në këtë sportel qytetarët asistohen edhe për bërjen e ankesës në portalin “Shqipëria që duam”.

Gjatë periudhës raportuese në kuadër të kalimit të shërbimeve të DPSHTRR në administrimin e ADISA-s, specialistët e sektorëve të ngarkuar në këtë proces kanë analizuar 76 shërbimet e ofruara nga DPSHTRR-ja. Grupi i punës zhvilloi disa vizita, pranë Drejtorisë Rajonale Tiranë, duke parë nga afër shërbimet e ofruara pasi një pjesë e konsiderueshme e këtyre shërbimeve, ofrohen pranë Drejtorive Rajonale Transportit Rrugor. Ky inspektim u krye për të kuptuar më mirë në cilat shërbime mund të realizohet ndarja FO-BO. Gjatë vizitave u vlerësua natyra e shërbimeve, proceset e ndjekura nga pritësit e sporteleve, menaxhimi i fluksit të qytetarëve si dhe aspekte të tjera që lidhen dhe ndikojnë në cilësinë e ofrimit të shërbimit në sportel.

Në total për 4-mujorin e parë në Zyrat Rajonale/Vendore ADISA janë shtuar 26 shërbime publike, të cilat i ofrohen qytetarëve sipas standardeve të vendosura.

- Treguesi A.3- Rritja e kënaqësisë së qytetarëve në marrjen e shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ADISA

Për tetë mujorin e parë të vitit 2019 gjatë muajit Prill është realizuar një sondazh për matjen e kënaqësisë qytetare pranë Zyrës Vendore Tiranë. Janë intervistuar në total 150 qytetarë të cilët kanë marrë shërbim pranë sporteleve të FO ADISA Tiranë, të cilët janë shprehur të kënaqur në masën 100% nga shërbimi i marrë në këto sportele. Duke filluar nga muaji Korrik 2019 po zhvillohen sondazhe telefonike për matjen e kënaqësisë qytetare në Qendrat e Integruara (Kavajë, Krujë, Fier dhe Gjirokastrë).

- Treguesi B.1 – Numri i Qendrave/Njësive të Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.

ADISA numëron 6 qendra të integruara (One Stop Shop) të ngritura në rang vendi, përkatësisht në Shkodër, Gjirokastrë, Krujë, Kavajë, Fier dhe Tiranë pranë Njesisë Administrative nr.6 në zonë zonën e Kombinatit. Gjatë 4-mujorit të dytë të vitit 2019 ADISA inauguroi qendrën e integruar në Tiranë në zonën e Kombinatit si OSS i parë i mirëfilltë me 18 sportele në kryeqytet, i cili do të mundësojë kryesisht për banorët e zonës dhe të rrethinave marrjen e shërbimeve të ASHK, ISSH, FSDKSH, QKB apo shërbimeve vendore të ofruara nga Bashkia Tiranë. Në këtë qendër mund aplikojnë për shërbime publike të ofruara me standardet më të larta të gjithë qytetarët e Tiranës.

Përveç One Stop Shop ADISA në 6 bashkitë e sipërpërmendura, gjithashtu funksionon dhe FO ADISA Tiranë, në të cilën për momentin ofrohen vetëm shërbimet e ASHK-së Tiranë, por brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2019 kjo zyrë do të përjetojë shndërrimin në një OSS të mirëfilltë ku do të ofrohen dhe shërbimet e disa institucioneve të tjera.

Gjithashtu për ngritjen e qendrave të integruara ADISA në Elbasan dhe Lushnje pritet lidhja e kontratës me kompanitë të cilat do të zhvillojnë rikonstruksionin e ambienteve dhe fillimi i punimeve. Zbatimi i projektit pritet të përfundojë në fund të 2019 duke e rritur numrin e qendrave të integruara ADISA në 9 brenda këtij viti.

Në të njëjtën kohë për ngritjen e qendrës së integruar ADISA në Durrës, nga ana e bashkisë po kryhen përgatitjet për kalimin e VKB. Më pas do të vijohet me detyrën e projektimit të kësaj qendre. ADISA Durrës pritet të përfundojë brenda gjashtë muajorit të parë të vitit 2020.

- Treguesi B.2 – Numri i Bashkive (jo qendër-qarku) në të cilën ADISA është prezent nëpërmjet sporteleve të saj.

Kjo mënyrë e shtrirjes së ADISA në territor u iniciua në Nëntor të vitit të kaluar nëpërmjet dy sporteleve One Stop Shop ADISA pranë zyrave të bashkisë Maliq të cilat i ofruan qytetarëve të Maliqit akses në shërbimet e institucioneve qendrore. Kjo mënyrë e shtrirjes së ADISA në territor është realizuar me sukses tashmë në 5 bashki: Maliqi, Patosi, Belshi, Divjaka dhe Librazhdi të cilat do të pasohen gjatë 6-mujorit të dytë nga bashkia e Malësisë së Madhe dhe Kukësit.

Prej muajit Nëntor 2018, qytetarët e Maliqit mund të përfitojnë 140 shërbime publike vendore të ofruara me standarde bashkëkohore të institucioneve si Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) nëpërmjet 2 sporteleve One Stop Shop ADISA.

Prej muajit Mars 2019, qytetarët e Bashkisë Belsh pranë One Stop Shop ADISA të kësaj bashkie mund të përfitojnë rreth 140 shërbime publike vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP).

Prej muajit Prill 2019, qytetarët e Bashkisë Patos pranë One Stop Shop të kësaj bashkie mund të përfitojnë shërbime publike vendore. ADISA në bashkëpunim me institucionin e Bashkisë, ofron shërbime publike nëpërmjet 2 sporteleve fizike. Tashmë dy sportelet e ADISA ofrojnë rreth 140 shërbime publike të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), Fondit për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP).

Që prej Korrikut, në 11 sportelet aktuale në One Stop Shop Librazhd, ADISA ofron mbi 310 shërbime publike të institucioneve si Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), me 27 shërbime që nuk kërkojnë kontroll fizik dhe 8 procedura të ndryshme, si dhe shërbime të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Pranë zyrës me një ndalesë do të ofrohen shërbime publike si të nivelit qendror dhe të nivelit vendor në një ambient të vetëm.

Prej Shtatorit u operacionalizua zyra me një ndalesë pranë ambientit të Bashkisë në qytetin e Divjakës, e cila është e pesta e këtij lloji pas asaj në Maliq, Belsh, Patos dhe Librazhd ku sportelet ADISA të shërbimeve publike qendrore bashkë vendosën në qendrën me një ndalesë të bashkisë.

Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark”, ish Hoteli i Oficerave, kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al

Tashmë, në 8 sportelet aktuale në One Stop Shop Divjakë, ADISA do të ofrojë mbi 200 shërbime publike të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit, etj.

Brenda vitit 2019 ADISA planifikon të zgjerojë sportelet One Stop Shop në minimalisht 7 Bashki të vendit, duke pasur përparësi Bashkitë në të cilat ADISA është apo do të jetë prezent gjatë 2019 me One Stop Shop në Bashki-Qendër Qarku. Duke ndjekur me përpikëri planin e shtrirjes në territor, deri në vitin 2021 ADISA do të ketë sportele One Stop Shop në 45 Bashki të vendit.

- Treguesi B.3 – Numri i njësive lëvizëse për ofrimin e shërbimeve publike.

Për të siguruar akses edhe në ato Njësi Administrative të konsideruara si zona të thella apo rurale, ku në shumicën e rasteve janë prezentë vetëm zyrat e gjendjes civile, gjithashtu duke marrë parasysh faktin se fluksi i transaksioneve në këto zona nuk e justifikon praninë e ADISA si me qendër të integruar apo me sportele One Stop Shop pranë zyrave të bashkive, një mënyrë alternative dhe inovative e ofrimit të shërbimit është menduar të jetë Njësia Lëvizëse.

Njësia lëvizëse do të pilotohet në Qarkun e Tiranës gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2019. Është zgjedhur Tirana, pasi të pasurit prezentë një qendër të integruar në Qendër Qarku, ndihmon në terma logjistike dhe operacionale. Pilotimi në këtë qark do të na mundësojë të testojmë këtë kanal alternativ dhe të kemi një vendimmarrje nëse ky model duhet të replikohet duke vendosur në balance vlerën e shtuar përkundrejt kostos.

Gjatë 4-mujorit të dytë të këtij viti është realizuar me sukses procesi i brandimit të fugonit dhe ky projekt pritet të operacionalizohet branda muajit Tetor. Shërbimet që do të ofrohen fillimisht në fazën e pilotimit të Njesisë Lëvizëse janë shërbimet e institucioneve si Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK); Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH); Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP). Gjithashtu qytetarët do të asistohen edhe për shërbime të cilat mund t'i përfitojnë online nëpërmjet portalit e-albania dhe do të mund të marrin informacion për rreth 950 shërbime publike.

- Treguesi B.4 – Numri i kartelave informative të standardizuara për shërbimet publike ndaj totalit të shërbimeve publike.

Përgjatë periudhës janar – gusht 2019, referuar kartelave informative, ADISA ka bashkëpunuar me 13 institucione të reja të administratës publike. Informacioni i kartelave informative gjenerohet përmes platformës IPSD të dedikuar për inventarizimin e shërbimeve publike, për t'u standardizuar më pas sipas formatit të miratuar nga ADISA.

Numri i kartelave informative të hartuara përgjatë 8-mujorit të parë të vitit është 50 për 13 institucione të cilat mbulojnë 50 shërbime publike. Numri total i kartelave informative të standardizuara është 978, nga të cilat 941 të standadizuara përmes platformës së shërbimeve publike IPSD, duke mbuluar një numër shërbimesh publike prej 941 të tilla. Institucionet dhe numri i shërbimeve janë pasqyruar në tabelën më poshtë:

Kartelat informative të hartuar në periudhën janar – gusht 2019		
Nr	Institucioni	Kartela informative të hartuara
1	Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore (QKCSAISH)	1
2	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)	1
3	Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH)	5
4	Instituti i Ndërtimit (IN)	5
5	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)	3
6	Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit (DPA)	1
7	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Minera (AKSEM)	5
8	Agjencia Kombëtare e Mjedit (AKM)	2
9	Drejtorja e Përgjithshme Detare (DPD)	1
10	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI)	9
11	Banka Kombëtare e Shqipërisë (BKSH)	8
12	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)	7
13	Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (DPSHMZSH)	2
Total		50

- Treguesi B.5 – Numri i formularëve të aplikimit, të standardizuar për shërbimet publike.

Gjatë periudhës janar – gusht 2019, sektori i Zhvillimit të Standardeve ka hartuar 34 formularë të rinj për 18 institucione konkretisht: Drejtorja e Përgjithshme Detare (DPD), Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK), Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (AQFA), Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH), Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), Enti Kombëtar i Banesave (EKB), Qendra e Personel Rekrutimit (QPR), Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF), Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK), Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore (QKCSAISH), Instituti i Monumenteve Kulturore (IMK), Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV), Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë (BKSH) dhe Drejtorja e të Drejtave të Autorit (DDA).

19 formularë të 11 institucioneve (AQFA, ARRS, DPD, DPM, EKB, IMK, ISHPSHSH, QKEV¹, QKIPK, QPR dhe SHGJSH) janë vënë në përdorim, si dhe mbulojnë 61 shërbime publike. Sa i përket institucioneve të tjera, sektori i Zhvillimit të Standardeve mbetet në pritje të miratimit dhe vënies në përdorim të formularëve të hartuar. Gjithashtu, gjatë këtij 8-mujori janë bërë përditësime për formularët e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS). Numri i formularëve në total është 325 për 41 institucione, nga të cilët 228 formularë të 29 institucioneve janë në përdorim dhe mbulojnë 379 shërbime.

Formularë aplikimi të standardizuar në periudhën janar – gusht 2019		
Nr	Institucioni	Formularë aplikimi të standardizuar
1	Drejtoria e Përgjithshme Detare (DPD)	1
2	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)	2
3	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)	1
4	Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK)	1
5	Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (AQFA)	1
6	Qendra e Personel Rekrutimit (QPR)	2
7	Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH)	2
8	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM)	5
9	Enti Kombëtar i Banesave (EKB)	1
10	Instituti i Monumenteve Kulturore (IMK)	2
11	Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV)	3
12	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA)	1
13	Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF)	1
14	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS)	1
15	Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK)	2
16	Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore (QKCSAISH)	1
17	Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë (BKSH)	1

¹ QKEV ka publikuar vetëm një nga tre formularët në faqen zyrtare.

18	Drejtoria e të Drejtave të Autorit (DDA)	6
Total		34

- **Treguesi B.6 – Shkurtimi i kohës së shërbimit në sportelet pritëse (shkurtimi kohës nga vit në vit).**

Gjate periudhës Janar - Prill është bërë përmirësimi i metodologjisë së matjes së kohës si dhe për të evidentuar gjendjen aktuale të kohës së pritjes në radhë dhe kohës së aplikimit në sportel gjatë muajit Shkurt 2019 është realizuar matja e kohës pranë Zyrës Vendore Tiranë. Në total janë realizuar 278 matje, nga analizimi i këtyre të dhënave u konstatua se mesatarisht koha e pritjes në radhë ishte 16 minuta dhe koha e aplikimit në sportel ishte 4 minuta. Krahasuar me matjen e kohës në periudhën e mëparshme (Shkurt 2018) ndryshimet në metodologji kanë dhënë një rezultat më rigoroz megjithëse ka pasur një rritje me 50 sekonda në kohën mesatare të aplikimit që ishte 3 minuta 10 sekonda, si dhe një rritje me 10 minuta e 36 sekonda në kohën e pritjes në radhë që ishte 6 minuta e 36 sekonda.

Gjatë muajit Qershor 2019 u realizua monitorimi i kohës së pritjes dhe kohës së aplikimit në Zyrën Vendore Krujë për të gjitha institucionet e ndodhura (ASHK, ISSH, FSDKSH, QKB, DPGJC, DPT dhe Sporteli Hibrid). Në total u realizuan 258 matje, nga ku rezultoi se një qytetari i duhet mesatarisht 1 minutë të presë në radhë dhe 4 minuta të marri një shërbim të caktuar. Për këtë Zyrë Vendore nuk ka bazë krahasimore për shkak se fluksi ka qenë konstantë gjatë gjithë periudhës dhe se koha e aplikimit është brenda standarde të kërkuara.

Gjithashtu gjatë muajve Gusht-Shtator 2019 u realizua monitorimi i kohës në Zyrën Rajonale Tiranë 2 për të gjitha institucionet e ndodhura (ASHK, ISSH, DPGJ dhe ALEAT). Në total u realizuan 536 matje, nga ku rezultoi se një qytetar shpenzon mesatarisht 31 minuta në Zyrën Rajonale Tiranë 2, nga të cilat 26 minuta pret në radhë dhe 5 minuta aplikon për shërbimin e nevojshëm. Për këtë Zyrë Rajonale ky është monitorimi i parë i realizuar pasi kjo zyrë ka filluar aplikimin që prej muajit Korrik 2019.

III. Buxheti i miratuar dhe faktik për 4 mujorin e parë të vitit 2019

000/lekë

Buxheti 2019	Plan	Fakt	% realizimit
Paga	106,541	65,959.3	62%
Sigurime Shoqërore	18,819	10,950.4	58%
Mallra dhe Shërbime të Tjera	30,000	20,759.8	69%
Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	115,000	45,759.9	40%

Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark”, ish Hoteli i Oficerave, kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al

Shpenzime Kapitale me financim të huaj	150,000	55,596.1	37%
--	---------	----------	-----

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zërat 600+601) janë realizuar në zbatim të strukturës të miratuar me VKM nr. 28 datë 23.01.2019 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.654, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara”. Shumat e realizuara për periudhën e raportimit janë përkatësisht 65,959.3mijë lekë për artikullin 600 dhe 10,950.4 mijë lekë për artikullin 601, që përkthehen në 96% të totalit të planifikuar për 8 mujorin. Ky realizim vjen si rezultat i numrit faktit të të punësuarve gjatë periudhës së raportimit si dhe pagesave respektive.

Numri faktik i punonjësve të punësuar në fund të muajit Gusht 2019 është 149 persona, nga të cilët 3 punonjës janë jashtë strukture. Brenda këtij numri janë përfshirë dhe 2 punonjëse me leje lindje të cilat marrin pagesë nga sigurimet shoqërore. Gjatë tetë mujorit të vitit 2019 janë punësuar si personel me kohë të plotë 23 punonjës. Të larguar nga puna gjatë kësaj periudhe kanë qenë 17 punonjës.

Fondi për shpenzime në mallra dhe shërbime (zëri 602), është realizuar në vlerën 20,759.8 mijë lekë ose 69% të totalit. Kjo masë realizimi konsiderohet si realizim shumë i mirë. Fondi i realizuar përfshin pagesat për procedurat e prokurimit për blerje, “Dietat brenda vendit”, “Shpenzime energji elektrike”, “Shërbim roje private”, “Shërbim postar”, “Shërbim telefoni”, “Shërbim mirëmbajtje automjeti”, “Siguracion automjeti”, “Blerje materiale mirëmbajtje”, shpenzime për ujësjellës kanalizime”, “Taksa bashkie”, etj.

Fondi për Investime të brendshme (zërat 230+231), është i detajuar:

1. Mbështetje për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike me në qendër qytetarin (TVSH) 15,000 mijë lekë, realizuar në masën 5,207.9 mijë lekë ose 35%.
2. Blerje pajisje TIK në shumën 10,000 mijë lekë, realizuar në shumën 1,048.8 mijë lekë ose 10%. Ky realizim vjen për shkak të procedurave të prokurimit të ndjekura nga AKSHI. Janë paguar gjithsej 5 lote të procedurës së prokurimit dhe mbetet në pritje edhe loti I fundit.
3. Rikonstruksioni i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Shkodër, kontraktuar në vlerën 45 371 493 lekë dhe likuiduar në vlerën 5 865 606 ose 12% e kontratës në vitin 2018. Për vitin 2019 fondi i detajuar për këtë projekt është 39,505.887mijë lekë. Realizimi i kontratës për periudhën e raportimit është 39,446,558 lekë ose 100%.

4. Kolaudimi i rikonstruksionit të Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Shkodër, kontraktuar në vlerën 92,570 lekë dhe likuiduar në vlerën 92,570 lekë ose 100% e kontratës.
5. Rikonstruksion i godinave të marra në përgjegjësi administrimi apo përdorim sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve publike plani vjetor 50,401.543 mijë lekë. Ky zë investimi është planifikuar për qendrat e reja që do të hapen gjatë vitit 2019. Detajimi i mëtejshëm do të bëhet me marrjen në dorëzim të projektit për qendrat. Realizimi i pritshëm deri në fund të vitit do të jetë 100%

Fondi për Investime të huaja (zërat 230+231), është miratuar në shumën 80,000 mijë lekë në zërin 230 dhe 70,000 mijë lekë në zërin 231. Financimi i huaj është i detajuar sipas regjistrit të prokurimeve të miratuar nga Banka Botërore. Nga ky fond janë realizuar në masën 27,869.0 mijë lekë ose 35% artikulli 230 dhe artikulli 231 në shumën 27,727.0 mijë lekë ose 40%. Në total fondi i investimeve të huaja është realizuar në vlerën 55,596.1 mijë lekë ose 37% e fondit total.

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		Institucione te tjera Qeveritare				Kodi i Grupit	87	
Programet		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit						
		(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2018	(2) PBA Viti 2019	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2019	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2019	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
Titulli	Emertimi							
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike	236,405.4	420,360.0	420,360.0	420,360.0	273,279.3	199,061.4	-74,217.9
Totali i Shpenzimeve te Ministrise		236,405.4	420,360.0	420,360.0	420,360.0	273,279.3	199,061.4	-74,217.9
Shpenzime nga te Ardhetur Jashte limitit								
Totali		236,405.4	420,360.0	420,360.0	420,360.0	273,279.3	199,061.4	

Nëpunësi Autorizues/Drejtor Ekzekutiv	Emri	Lorin YMERI
	Firma	
	Data	30.09.2019

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit	Institucione te tjera Qeveritare						Kodi i Grupit	87
Programi	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike						Kodi i Programit	01330
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2018	(2) PBA Plan Viti 2019	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2019	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2019	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	96,226.7	116,541.0	116,541.0	106,541.0	67,694.0	65,959.3	-1,734.7
601	Sigurime Shoqërore	15,939.5	18,819.0	18,819.0	18,819.0	12,546.0	10,950.4	-1,595.6
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	24,693.2	20,000.0	20,000.0	30,000.0	28,039.3	20,759.8	-7,279.6
603	Subvencione							0.0
604	Transferta Korente të Brendshme							0.0
605	Transferta Korente të Huaja							0.0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ							0.0
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	136,859.3	155,360.0	155,360.0	155,360.0	108,279.3	97,669.5	-10,609.9
230	Kapitale të Patrupëzuara							0.0
231	Kapitale të Trupëzuara	38,925.6	115,000.0	115,000.0	115,000.0	65,000.0	45,795.9	-19,204.1
232	Transferta Kapitale							0.0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	38,925.6	115,000.0	115,000.0	115,000.0	65,000.0	45,795.9	-19,204.1
230	Kapitale të Patrupëzuara	54,413.9	80,000.0	80,000.0	80,000.0	53,333.3	27,869.0	-25,464.3
231	Kapitale të Trupëzuara	6,206.5	70,000.0	70,000.0	70,000.0	46,666.7	27,727.0	-18,939.6
232	Transferta Kapitale							0.0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	60,620.5	150,000.0	150,000.0	150,000.0	100,000.0	55,596.1	-44,403.9
Totali	Shpenzime Kapitale	99,546.0	265,000.0	265,000.0	265,000.0	165,000.0	101,391.9	-63,608.1
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti							0.0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		236,405.4	420,360.0	420,360.0	420,360.0	273,279.3	199,061.4	-74,217.9

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri Jonida TARAJ	Nëpunësi Autorizues/Drejtor Ekzekutiv	Emri	Lorin YMERI
	Firma		Firma	
	Data 30.09.2019		Data	30.09.2019

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Institucione te tjera Qeveritare	Kodi i Grupit	87
Programi	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike	Kodi i Programit	01330

	ne 000/leke				I			II			III			IV	Luhatjet ne Koston per Njesi			
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njesia matese	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III	Komente
A.1	Numri i shërbimeve të ri-inxhinieruara	Numër	-	-	-	424	42,036	99	424	42,036	99	424	19,906	47	-	-52	-52	
A.2	Numri i shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ndaj totalit të shërbimeve publike	Numër	367	118,203	322	415/1300	252,216	608	415/1300	252,216	608	418/1300	119,437	286	-36	-321	-321	
A.3	Rritja e kënaqësisë së qytetarëve në marrjen e shërbimeve në sportelet ADISA	%	90	118,203	1,313	74%	126,108	170,416	74%	126,108	170,416	100%	59,718	59,718	58,405	-110,698	-110,698	

Treguesit e Performances/Produktet e realizuara nga perdorimi i te ardhurave jashte limitit					
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njesia Matëse	Sasia e realizuar	Fakti i periudhes/progresiv	Komente
A	Produkti			0.0	
D	Treguesi i Performances			0.0	

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Jorida TARAJ	Nëpunësi Autorizues/Drejtor Ekzekutiv	Emri	Lorin YMERI
	Firma			Firma	
	Data	30.09.2019		Data	30.09.2019

ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"

Periudha e Raportimit:

Kodi i Programit	01330	Emertimi i programit:	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike						Komente
Qellimi 1	Implementimi i rregullave për ofrimin e shërbimeve publike nga institucionet publike për personat që banojnë dhe/ose ushtrojnë aktivitetin e tyre në Republikën e Shqipërisë përmes heqjes së pengesave administrative dhe ofrimit të tyre në një kohë sa më të shkurtër.								
			**Treguesit e performancës/Produktet:						
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1.1	Shërbime publike të përmirësuara, të aksesueshme dhe të integruara, duke përmirësuar efektivitetin e ofrimit të tyre.								
			1. Numri i Qendrave/Njesive te Ofrimit te Sherbimeve Publike te Integruara	5	9	9	7	78%	
			2. Numri i Bashkive(jo qender-qarku) ne te cilen ADISA eshte prezente nepermjet sporteleve te saj	1	6	6	5	83%	
			3. Numri i njesive levizese per ofrimin e sherbimeve publike	0	1	1	1	100%	
			4. Numri i kartelave informative te standardizuara per sherbimet publike ndaj totalit te sherbimeve publike	891/1300	970/1300	970/1300	978/1300	101%	
			5. Numri i formularëve të aplikimit, të standardizuar për shërbimet publike	608/1300	310	310	325	105%	
			6. Matja e kohës së shërbimit në sportelet pritëse.	0	4'	4'	4'	100%	

* Objektivat e listuar jane ne funksion te permbushjes se qellimit te mesiperm te politikës. Nese specifikohet me shume se 1 Qellim, ai se bashku me objektivat e tij (psh Qellimi 2 me Objektiv 2.1; 2.2; etj) duhet te futen ne nje table tjeter te ngjashme, ne vazhdim te kesaj.

** Si tregues për vlerësimin e performancës së objektivave, krahas produkteve, shërbejnë edhe tregues të tjerë të matshëm të lidhur me to. Këto mund të jene standarte të njohura të fushës; tregues statistikorë; indekse kombëtare e ndërkombëtare,etj.

*** Ketu listohen te gjithë treguesit e performances, perfshi dhe produktet. Raportimi per produktet behet periodik dhe vjetor, ndersa raportimi per treguesit e performances mund te behet edhe vetem vjetor, nqs matshmeria e tyre periodike paraqet veshtiresi objektive.

Njekohesisht, per ata tregues performance te cilet nuk vleresohen mbi baze vjetore por disa vjecare (psh vleresime ndekombetare te tilla si: OBI, PISA score, PEFA score, etc), si nivel i vitit paraardhes vendoset niveli me i fundit i regjistruar per ta.

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Jonida TARAJ	Nëpunësi Autorizues/Drejtor Ekzekutiv	Emri	Lorin YMERI
	Firma			Firma	
	Data	30.09.2019		Data	30.09.2019

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"**Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)**

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti 2019 Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (8-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M870294	Mbështetje për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike me në qendër qytetarin (TVSH)	29,331.88	2017	2019	15,000.00	15,000.00	5,207.93	5,207.93	5,207.93	
18AP201	Blerje pajisje TIK	10,000	2019	2019	10,000.00	10,000.00	1,048.80	1,048.80	1,048.80	Janë marrë në dorëzim dhe paguar 5 lote të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje Pajisje TIK". Pritet edhe loti i fundit të vijë kontrata e lidhur nga AKSHI dhe operatori fitues
18AP301	Rikonstruksion i godinave të marra në përgjegjësi administrimi apo përdorim sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve publike	50,401.54	2019	2019	50,401.54	50,401.54	-	-	-	Ky zë investimi është planifikuar për qendrat e reja që do të hapen gjatë vitit 2019. Detajimi i mëtejshëm do të bëhet me marrjen në dorëzim të projektit për qendrat. Realizimi i pritshëm deri në fund të vitit do të jetë 100%
M870339	Rikonstruksioni i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Shkodër	45,371.49	2018	2019	39,505.89	39,505.89	39,446.56	39,446.56	39,446.56	Kontrata ka përfunduar dhe është likuaduar në masën 100%
M870126	Rikonstruksioni i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Shkodër	92.57	2019	2019	92.57	92.57	92.57	92.57	92.57	Kontrata ka përfunduar dhe është likuaduar në masën 100%

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant/ Kredi	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Vitit i përfundimit të projektit	Buxheti 2019 Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
KM87002	Ofrimi i shërbimeve me në qendër qytetarin	kredi	878,500	2015	2020	150,000	150,000	29,040	55,596	55,596.10	

Drejtuksi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Jonida TARAJ	Nëpunësi Autorizues/Drejtor Ekzekutiv	Emri	Lorin YMERI
	Firma			Firma	
	Data	30.09.2019		Data	30.09.2019